

Nënkryetarët e komunave për komunitete (NKKK) 2018

Nënkryetari i komunës për komunitete është mekanizëm lokal mbrojtës që është i detyrueshëm në komunat ku komunitetet në pakicë numerike përbëjnë të paktën 10 % të popullsisë së komunës. Kjo pozitë mund të themelohet po ashtu edhe në ato komuna ku numri i banorëve nga radhët e komuniteteve në pakicë numerike nuk e arrin pragun prej 10%, me vendim të kuvendit të komunës. NKKK ka mandat që të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin për çështje që lidhen me komunitetet dhe duhet t'i përfaqësojë të gjitha komunitetet që banojnë në komunë. Kandidatin për NKKK e propozon kryetari i komunës dhe e miraton kuvendi i komunës.. Dokumentet kryesore që rregullojnë krijimin dhe mandatin e NKKK-ve janë Ligji për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03 / L-040, 2008), Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve të komunave dhe Termat e referencës për NKKK.

Krijimi i pozitës së NKKK


Pozita e NKK është krijuar tashmë në 16 nga 38 komuna - **komunat ku ky post është i detyrueshëm pasi që plotësohet pragu prej 10% janë shenjuar me të zeze të mbylltë:**

Dragash*	Mamushë
Ferizaj	Mitrovicë Jugore**
Fushë Kosovë	Novobërdë
Graçanicë**	Obiliq
Kamenicë*	Prizren**
Klllokot**	Shtërpcë
Leosaviq**	Zveçan
Lipjan	Zubin Potok

* Në Dragash pozita është krijuar rishtazi, më 19 dhjetor 2017. Në Kamenicë, mekanizmi ishte shpërbërë nga kryetari i komunës në dhjetor të vitit 2016 pas dorëheqjes së NKKK-së së atëhershëm. Megjithatë, mekanizmi u krijua sërish në mars të vitit 2018.


** Në Graçanicë, Klllokot, Leosaviq, Mitrovicë Jugore dhe Prizren, pozita është krijuar gjatë kësaj periudhe raportuese porse NKK nuk është emëruar.

NKK-të sipas komunitetit



NKK-të sipas gjinisë


*Mamushë




Numri i NKKK-ve që realizojnë detyra siç përcaktohet me legjislacion

(Sipas monitorimeve të rregullta të ekipeve në terren të OSBE-së dhe rishikimeve periodike specifike nga ekipet në terren, si edhe raporteve që kanë nxjerrë komunat)


Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet




Mbështetja e kërkesave të komunitetet drejtuar trupave komunale




Realizimi i vizitave informuese tek komunitetet dhe/ose promovimi i aktiviteteve informuese të komunës




Sigurimi i zbatimit efektiv nga ana e ekzekutivit të komunës të projekteve /aktiviteteve/politikave/ rregulloreve lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve




Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve



Promovimi i ndërtimit të besimit të ndërsjellë mes komuniteteve dhe institucioneve komunale



Siguron se janë paraparë fonde të mjaftueshme në buxhet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit dhe se nevojat dhe interesat e komuniteteve merren parasysh gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit*



*Në Ferizaj dhe Kamenicë, NKK nuk ishte në detyrë gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit

■ Po ■ Jo

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSCE) ofron mbështetje për përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset e vendimmarrjes e qeverisjes si dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, OSBE-ja e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim t'u ofrojnë institucioneve relevante tregues që mund t'u ndihmojnë për t'i identifikuar mangësitë në respektimin e kriterëve ligjore.

Zëvendëskryesuesit e kuvendit të komunës për komunitete (ZKKKK) 2018

Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete është mekanizëm lokal mbrojtës që është i detyrueshëm në komunat ku komunitetet përbëjnë të paktën 10% të popullsisë së komunës. Është i mandatar për t'i shqyrtuar të gjitha ankesat nga pjesëtarët e komunitetit në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të kuvendit komunal dhe është përgjegjës për referimin e shkeljeve të tilla në kuvendin e komunës. ZKKKK mund të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit përkatës. Përveç kësaj, në rrethana specifike, ZKKKK mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe t'ia paraqesë aktet ose vendimet që konsideron se shkelin një të drejtë të garantuar me kushtetutë. Kjo pozitë nuk mund të themelohet në komunat ku popullsia nga radhët e komuniteteve në pakicë numerike nuk e arrin pragun prej 10 % dhe mbahet nga anëtarët e komunitetit i cili merr më së shumti vota nga lista e hapur e kandidatëve për zgjedhjet komunale. Dokumentet kryesore që rregullojnë krijimin dhe mandatin e ZKKKK-ve janë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Nr.03/L-040, 2008) dhe Udhëzuesi për ZKKKK.

Krijimi i pozitës së ZKKKK

ZKKKK-të janë krijuar tashmë në 10 nga 38 komuna:


Fushë Kosovë	Mitrovicë Veriore**
Shtime	Novobërdë
Shtërpcë	Prizren
Kllokot	Zveçan**
Leposaviq*	Zubin Potok**

* Në Leposaviq, komuna nuk e ka emëruar askënd në këtë pozitë.

** Paqartësia në lidhje me krijimin e pozitës për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullatës në këto komuna.

Vini re: Në Shtime, kjo pozitë është krijuar në kundërshti me kuadrin ligjor dhe të politikave në fuqi; Në Graçanicë, pozita nuk është krijuar përkundër pranisë së komuniteteve që përbushin pragun prej 10%.

ZKKKK-të sipas komunitetit




ZKKKK-të sipas gjinisë

Gjatë periudhës së raportimit, të gjithë ZKKKK-të ishin burra.


Numri i ZKKKK-ve që realizojnë detyra siç përcaktohet me legjislacion

(Sipas monitorimeve të rregullta të ekipeve në terren të OSBE-së dhe rishikimeve periodike specifike nga ekipet në terren, si edhe raporteve e që kanë nxjerrë komunat)


Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve



Adresimi i shqetësimeve dhe çështjeve që lidhen me nevojat e komuniteteve në mbledhjet dhe punimet e kuvendit komunal




Shqyrtimi i pretendimeve nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre që aktet ose vendimet e kuvendit komunal shkelin të drejtat e tyre të garantuara me kushtetutë***



***Në raste të tilla, hapi i radhës për ZKKKK-në do të jetë që të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit në kuvendin e komunës. Nëse kuvendi nuk e rishqyrton aktin apo vendimin ose ZKKKK konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai e parashtron çështjen në Gjykatën Kushtetuese.

Funksionimi & Raportimi



ZKKKK-të me plan të punës në vitin 2018

ZKKKK-të të cilët kanë raportuar për punën e tyre para kuvendit të komunës në vitin 2018